



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr 174/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rafet Haxhaj kryesues, Adnan Konushevcu dhe faton Ademi anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e zyrtarit të lart ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkritazi me ankesën e Institutit Demokratik i Kosovës (KDI), paraqitur kundër Koalicionit LDK-AKR, për shkak të vendosjes së posterave në shenjat publike të trafikut, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 09.06.2017, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet si e bazuar ankesa e Institutit Demokratik I Kosovës (KDI) ashtu që Koalicionit LDK-AKR, i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 2,900.00 (dymijë e nëntëqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

Me datën 08.06.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga Institutit Demokratik I Kosovës (KDI) me të cilën pretendon se me datën 07.06.2017 në rrugën kryesore te qytetit Idriz Seferi në Gjilan ne afërsi te spitali rajonal monitoruesit e tyre kane hasur ne poster te kandidatëve per deputet nga koalicioni LDK-AKR te ngjitur ane shenja te komunikacionit. Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se është bërë shkelje e dispozitës së Nenit 33 paragrafi 1 pika b) të LZP-së. Në mbështetje të pretendimeve në ankesë ka bashkangjitur fotografi të printuara nga vendi i ngjarjes në cilësi të provës materiale.

Në përgjigje në ankesë të datës 09.06.2017, koalicioni LDK-AKR, thekson se kane urdhëruar kandidatet qe te ndermarin veprime permisuese me çka edhe është evituar shkelja. Si dëshmi ka bashkangjitur fotografi me të cilat dëshmohet largimi i posterit nga vendi ku ka qenë i vendosur ai.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

Ankesa është e bazuar

Nga fotografitë e ofruara si provë e cila gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se posterit i kandidatës për deputet nga Koalicioni LDK-AKR është i vendosur në shenja të komunikacionit, veprime këto që janë në kundërshtim me nenin 33 pika b) të LZP-së e cila përcakton: “*Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në shenjat publike të trafikut.*”

Duke u nisur nga arsyet e theksuara me lartë, Paneli konstaton se nga provat e ofruara shihet qartë se nga ana e koalicionit LDK-AKR, është shkelur neni 33 pika (b) të LZP-së, pasi që posterit i kandidates për deputet nga koalicioni LDK-AKR, është i vendosur në shenjat publike të trafikut.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura me fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret ngase subjektet politike të koalicionit LDK-AKR, kanë marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara që do të thotë se janë të njoftuar me rregullat zgjedhore, dhe se përkundër këtij fakti posterit i kandidates për deputete nga ky koalicion është i vendosur në shenjat publike të trafikut ku koalicioni në fjalë ka bërë disa herë përsëritjen e të njëjtës shkelje në këto zgjedhje. Poashtu si rrethanë Paneli mori edhe faktin se Koalicionit në fjalë ia mundësuar për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjen e pranuar nga ana e tyre shihet qartë se brenda afatit të caktuar kanë ndërmarr veprime për të bërë përmisimin e shkeljes ashtu që kanë tërhequr posterin nga vendi i palejuar, i cili veprim ka ndikuar në lartësin e gjobës së shqiptuar në dispozitiv të këtij vendimi

Paneli në kuptim të nenit 120.1 pika c) dhe nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës

Anr.174/2017 më datën 09.06.2017.



Kryesuesi i Panelit
Rafet Haxhaj

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.